

# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AFATIN E MESËM - NJË DOKUMENT I RËNDËSISHËM PËR BANKËN DHE POLITIKËN EKONOMIKE NË SHQIPËRI

Me vendim Nr. 111, datë 17.11.1999, të Këshillit të Mbikëqyrjes<sup>1</sup> u miratua Strategjia e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm.

Varianti i parë i Strategjisë u hartua një vit më parë dhe u rishikua e u diskutua në të gjitha nivelet e punonjësve të Bankës së Shqipërisë. Ai u miratua në parim nga Këshilli Mbikëqyrës, në shkurt 1999, duke i lënë një periudhë kohe prej gati 10 muajsh që të testohet, të përmirësohet dhe të diskutohet më tej nga të gjitha strukturat e Bankës.

Kjo edhe për arsien që Banka, për herë të parë, hartoi një dokument të kësaj natyre dhe u përpoq të jepte edhe një shembull të transparencës së institucionit dhe rritjes së komunikimit brenda tij.

Nga ana tjetër, kishim bindjen se përcaktimi i kësaj strategjie kërkonte jo vetëm një hedhje të disa ideve, por edhe studime më të thelluara në aspekte të veçanta të saj, duke mbajtur në konsideratë një sërë faktorësh ndikues që veprojnë brenda e jashtë institucionit.

Në kuadrin e mungesës së një strategjie kombëtare zhvillimi, Banka e Shqipërisë ndërmoi këtë iniciativë për të mbushur, së paku, boshllëkun në fushën që ajo mbulon. Dhe kjo fushë nuk është pak. Banka e Shqipërisë formulon dhe zbaton politikën monetare të vendit që është një nga drejtimet e rëndësishme të politikës ekonomike. Nga kjo pikëpamje, formulimi i Strategjisë së zhvillimit të institucionit përcakton edhe piketat ku do të ecet në afatin e shkurtër për zbatimin e politikës monetare.

Nga ana tjetër, ambiciet legjitime të përfshirjes në proceset integruese europiane e më gjerë diktuan nevojën për t'i paraprirë procesit me strategji të menduara. Gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti ngjarjet e rajonit, aq më shumë, shtruan domosdoshmërinë e pasqyrimin në punën tonë të ndryshimeve që diktuan rrethanat e reja dhe pranimi i Paktit të Stabilitetit.

## QËLLIMI DHE RËNDËSIA E STRATEGJISË

**Qëllimi** i formulimit të këtij dokumenti është shumëplanësh.

1. Qëllimi i përgatitjes së Strategjisë së Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë **është të përcaktojë objektivat** afatshurtër dhe afatmesëm, të cilët synohen të arrihen.
2. Dokumenti ka për qëllim **të vlerësojë nivelin e arritur** në zhvillimin institucional, si dhe të tregojë rrugët nga u kalua për të arritur deri këtu.
3. Formulimi i Strategjisë ka për qëllim edhe **përcaktimin e afateve kohore** të realizimit të objektivave.

<sup>1</sup> Teksti i plotë i këtij dokumenti është botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, dhjetor 1999.

4. Strategjia nëpërmjet përcaktimit të rrugës së zhvillimit **vendos prioritetet** dhe mënyrën e realizimit të tyre në afatin e mesëm.

Formulimi i një dokumenti të tillë ka rëndësi sepse:

1. bën transparente synimet e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë duke i prezantuar ato të renditura dhe të analizuar, si për vetë institucionin ashtu edhe për publikun;
2. shmang zhvillimet rastësore të institucionit dhe bashkërendon më mirë punën ndërmjet departamenteve;
3. përcakton në mënyrë konkrete rrugën ku dhe si do të ecet për të realizuar objektivat e vendosura me ligj dhe përmbushjen e funksioneve të Bankës.

#### **PËRMBAJTJA E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AFATIN E MESËM**

Dokumenti i miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes përbëhet nga 5 pjesë kryesore.

Ai fillon me një **hyrje**, ku prezantohet qëllimi dhe rëndësia e shkruarjes së dokumentit.

Në **pjesën e dytë**, paraqitet një vështrim historik mbi sistemin bankar, gjendja dhe synimet e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar në afatin e shkurtër. Aty trajtohet sistemi bankar shqiptar deri në ditët tona si dhe ristrukturimi dynivelesh i tij mbas vitit 1992. Gjithashtu, në këtë pjesë paraqitet shkurtimisht Banka e Shqipërisë dhe funksionet e saj mbas ristrukturimit. Aty përshkruhen gjendja dhe synimet në programet ESAF 1 dhe 2 si dhe rezultatet e arritura deri në ditët tona.

Në **pjesën e tretë**, trajtohet Strategjia e përgjithshme e zhvillimit të Bankës. Në këtë pjesë, që përfaqëson edhe trungun kryesor mbi të cilin ngrihet ky dokument, përcaktohet se cili do të jetë modeli institucional që do të mbahet në konsideratë nga ana e Bankës së Shqipërisë në procesin e përsosjes së punës dhe afrimit me standardet ndërkombëtare. Strategjia përcakton se modeli, nga i cili do të orientohet gradualisht Banka e Shqipërisë, është ai i Bankës Qendrore Europiane. Arsyet për këtë zgjedhje janë gjetur tek vendndodhja gjeografike, tradita e lidhjeve ekonomike si dhe peshat në strukturat e import-eksportit të Shqipërisë.

Gjithashtu, u gjykua se ky model përmban elemente të kompromisit, të favorshme për një bankë qendrore të re si ajo e Shqipërisë. Nga ana tjetër, zona e veprimit të euro-s mbulon një pjesë të madhe të vendeve të cilat, aktualisht dhe në perspektivë, mendohet se do të jenë partnerët kryesorë ekonomik të vendit. Në këtë pjesë tregohet se procesi i gjatë dhe kompleks i përshtatjes me standardet europiane do të imponojë ndryshime që zënë fill nga instrumentet e politikës monetare deri tek ndërtimi i përshtatur strukturor i Bankës së Shqipërisë, infrastruktura dhe politikat e punësimit e kualifikimit, teknologjia dhe organizimi i informacionit, etj. Kjo mendohet të bëhet me etapa, duke krijuar kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në afatin e gjatë në institucionet europiane dhe më gjerë.

Niveli i pavarësisë së Bankës përbën një tjetër problem që trajtohet në strategjinë e

zhvillimit afatmesëm të institucionit. Kjo çështje trajtohet nga dy këndvështrime. Së pari, duke interpretuar nocionin e pavarësisë brenda kompetencave të përcaktuara me ligj dhe duke treguar pse ajo është e domosdoshme. Së dyti, duke theksuar realizimin *de facto* të kësaj pavarësie të përcaktuar me ligj. Kjo e fundit është parë si një rritje e shkallës së kredibilitetit të Bankës, e hapjes, informimit dhe transparencës me publikun, sidomos për sa i takon vendimeve të politikës monetare.

Plotësimi dhe përmirësimi i paketës ligjore dhe rregullatore si dhe ndërgjegjësimi i publikut janë dy probleme të tjera që trajtohen si prioritete të zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Veçanërisht kjo e fundit, është parë në strategjinë e miratuar si një element i rëndësishëm i punës në të ardhmen. Trajtimi i publikut si një aleat i natyrshëm i Bankës, përballë sfidave të zhvillimit ekonomik dhe reformave, do të realizohet nëpërmjet zgjerimit të komunikimit brenda dhe jashtë bankës, rritjes dhe përmirësimit të publikimeve, zgjerimit të informimit dhe masa të tjera që lidhen me marrëdhëniet me homologët në botë.

Politika monetare dhe tregjet financiare mbulojnë fushën më të rëndësishme në këtë pjesë të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve përbën objektivin kryesor të punës së Bankës të përfshirë në ligj dhe të detajuar në programin monetar dhe atë ESAF. Ndjekja e ecurisë dhe analiza e inflacionit, e trajtuar në një syth të veçantë në strategji, është parashikuar që të bëhet nëpërmjet arritjes së objektivit të ndërmjetëm sasior, siç është rritja e ofertës së parasë, kur baza monetare mund të shihet si një objektivi ndërmjetës i përshtatshëm.

Nga ana tjetër, agregate më të gjera monetare do të ishin më të përshtatshëm në të ardhmen si tregues për hartimin e politikës monetare. Në të njëjtin syth diskutohen edhe objektivat strategjike për përdorimin e instrumenteve të politikës monetare si dhe kalimin gradual nga instrumentet direkte në ato indirekte në afatin e mesëm. Hapi i parë në këtë drejtim është konsideruar heqja e kufirit të kredisë. Zhvillimi i tregjeve financiare si ai i parave, tregu valutash dhe ai i kapitaleve janë pjesë e strategjisë së Bankës në afatin e mesëm, nëpërmjet parashikimit e planifikimit konkret të hapave që do të ndërmerren për nxitjen e mëtejshme të tyre. Po ashtu, në kushtet e vazhdimit të zbatimit të një regjimi fleksibël të kursit të këmbimit, administrimi i rezervës valutore do të përsoset duke synuar zvogëlimin e borxhit të jashtëm të Qeverisë, si dhe për të përballuar importet kur ato nevojiten.

Në **pjesën e katërt** të këtij dokumenti, përshkruhen zhvillimet strategjike të funksioneve të tjera të Bankës. Përsosja e mbikëqyrjes bankare si një nga detyrat më të rëndësishme që realizon Banka e Shqipërisë, trajtohet me hollësi në strategji. Detyrat që duhen realizuar në afatin e mesëm dhe objektivat që ka Banka e Shqipërisë për afrimin e standardeve me nivelet ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes janë parë në katër drejtime kryesore: a- Mbikëqyrja e procesit të hyrjes së bankave të reja; b- Kuadri rregullator dhe mbikëqyrja e bankave të nivelit të dytë; c- Mbikëqyrja e ecurisë financiare të bankës; dhe d- Mbikëqyrja e procesit të trajtimit të bankave me probleme.

Zhvillimi i statistikave dhe fuqizimi i sektorit kërkimor përbëjnë, gjithashtu, një prioritet në zhvillimin afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Është konsideruar si mjaft e rëndësishme që Banka të konsolidojë dhe zhvillojë statistikën mbështetur në nivele ndërkombëtare standarde. Ky standardizim, në afatin e mesëm, do të arrihet

nëpërmjet punës për anëtarësimin në dy sisteme standarde të shpërndarjes së të dhënave, GDDS dhe SDDS.

Po ashtu, detyra prioritare janë përcaktuar përmirësimi i lëvizjes së informacionit brenda Bankës, përmirësimi i cilësisë së të dhënave si dhe thithja e tij nga burime alternative. Realizimi i tyre do të bëhet nëpërmjet asistencës së huaj teknike, duke mbajtur në konsideratë edhe kujdesin e saktësinë në përpunimin e të dhënave. Zhvillimi i aftësive kërkimore është konsideruar si një nga objektivat më afatgjatë dhe që do të implementohet me faza. Përgatitja e nevojshme e kapitalit human, fuqizimi i funksionit kërkimor të njësisë përkatëse dhe përgatitja e analizave për autoritetet e Bankës dhe publikun janë përcaktuar si drejtime të rëndësishme, që do të ndikojnë në rritjen e cilësisë së vlerësimeve të ekonomisë që bën Banka krahas realizimit të parashikimeve dhe të programimeve.

Për një Bankë relativisht të re, siç mund të konsiderohet Banka e Shqipërisë, zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit, në kushtet kur jetojmë në një botë gjithnjë e më të informatizuar e të organizuar, është konsideruar si një hap i rëndësishëm që duhet realizuar në afatin e mesëm për arritjen e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Duke qenë të ndërgjegjshëm se jemi në hapat e parë të zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe duke njohur domosdoshmërinë e këtij zhvillimi për ecurinë e Bankës, drejtimet ku do të përqendrohen përpjekjet janë në zgjerimin e njohurive dhe të eksperiencës, organizimit më të mirë të burimeve njerëzore, thellimit të procesit të automatizimit, implementimit të sistemeve informative si dhe zhvillimit të sistemit të informacionit raportues e statistikor.

Përsosja e sistemit të pagesave dhe kontabilitetit është pjesë përbërëse e strategjisë afatmesme të Bankës. Meqenëse Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës i sistemit të pagesave në Shqipëri dhe institucioni përgjegjës për funksionimin normal të tij, objektiv strategjik për përsosjen e këtij sistemi është rritja e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar, pra reduktimi i përdorimit të *cash*-it. Kjo do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të sistemit të pagesave ndërbankare dhe nëpërmjet përmirësimit të pagesave në vlera të vogla në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë. Strategjia e përmirësimit të sistemit të pagesave ndërbankare do të realizohet nëpërmjet implementimit të një sistemi të tipit RTGS. Nga ana tjetër, Banka synon të automatizojë sistemin e kleringut duke rritur bashkëpunimin me bankat e nivelit të dytë. Në këto përpjekje do të ndikojë edhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator të sistemit të pagesave.

Sistemi i Kontabilitetit, si një mjet në shërbim të nevojave të drejtimit të brendshëm, do të vazhdojë të përsoset në afatin e mesëm me objektiv strategjik që të shërbejë edhe si një mjet për t'i komunikuar publikut informacionin e nevojshëm dhe transparent, apo si mjet për ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e Bankës. Në zbatim të këtij objekti strategjik në afatin e mesëm do të synohet modernizimi i sistemit kontabël dhe përputhja e tij me standardet ndërkombëtare.

Në funksionet e saj si bankë qendrore Banka e Shqipërisë ka ekskluzivitetin e emetimit të monedhës kombëtare. Lidhur me këtë funksion në strategji përcaktohen drejtimet kryesore ku do të përqendrohet emetimi i monedhës në vitet që vijnë.

Zhvillimi i suksesshëm i institucionit në afatin e mesëm varet nga shkalla e aftësive dhe kualifikimit të burimeve njerëzore në Bankë. Për këtë arsye kjo fushë e rëndësishme trajohet në strategji duke analizuar prioritetet e menaxhimit dhe kualifikimit të kapitalit human. Kështu, do të synohet që ky proces të sigurojë harmonizimin e interesave aktuale dhe perspektive të Bankës me ato të punonjësve, lidhur me kualifikimin dhe karrierën e tyre. Gjithashtu, përcaktohet si i domosdoshëm realizimi i procesit të vlerësimit të punës dhe motivimit të punonjësve duke planifikuar krijimin e kushteve optimale jo vetëm të punës, por edhe të pushimit, argëtimit e shlodhjes.

Të gjitha këto detyra strategjike nuk mund të realizohen pa zhvillimin e infrastrukturës në Bankën e Shqipërisë. Për këtë arsye, në dokumentin e strategjisë zenë një vend modest edhe problemet e përmirësimit të ambjenteve të punës, të mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe përmirësime të strukturës organizative.

**Pjesa e pestë** dhe e fundit e Strategjisë së zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm trajton, në formën e shënimeve përmbyllëse, lidhjen që ka realizimi i detyrave strategjike me mjedisin ekonomik shqiptar. Elemente të veçuara të bashkëpunimit ndërmjet këtij mjedisi ekonomik dhe Bankës janë të përfshira në programet ekonomike të zhvillimit të vendit dhe sidomos në të dyja programet ESAF. Megjithatë, në Strategji theksohet se disa tregues të caktuar si rritja ekonomike, deficitit buxhetor, reforma strukturore dhe privatizimi, demokratizimi i shoqërisë, anëtarësimi në organizma ndërkombëtare etj, përbëjnë parakushte për suksesin e zbatimit të këtij dokumenti në afatin e mesëm.

Meqenëse Strategjia e zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë është konsideruar të jetë edhe një dokument vetëvlerësimi, bëhen përpjekje, ndoshta për herë të parë në një dokument si ky, për të përcaktuar pikat e forta dhe të dobëta të tij. Kështu, Strategjia e Bankës së Shqipërisë është përpjekja e parë për një analizë pa eufori dhe me detyra të përcaktuara për një spektër të gjerë sektorësh të Bankës dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Ai është një program koherent e realist që mbështetet në arritjet, por merr në konsideratë edhe vështirësitë. Ne vlerësojmë se ai është një program modern që përqipet të mbështetet në elemente teorike e praktike të drejtimit bashkëkohor të bankingut .

Por, ne jemi të ndërgjegjshëm edhe për anët e dobëta të tij. Mungesa e analizave të plota statistikore e bën strategjinë relativisht të vështirë për t'u konceptuar si një program konkret. Kjo bën që, sidomos për funksionet kryesore të Bankës, ajo të marrë, në ndonjë rast, trajtën e një plani masash. Nga ana tjetër, përcaktimi i kostove të vërteta të realizimit përbën një vështirësi, që vetëm pjesërisht varet nga ne. Gjithashtu, shkalla e njohjes së disa problemeve që lidhen me integrimin në sistemet europiane e më gjerë, është e kufizuar. Nuk duhet harruar se hartimi i këtij dokumenti bëhet kur stabiliteti i zhvillimit ekonomik e institucional të vendit ka ende elemente pasigurie.

## **REALIZIMI I STRATEGJISË**

Angazhimi i Bankës për ta realizuar këtë dokument është maksimal. Por, realizimi i strategjisë së zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, sikurse thamë më lart, nuk përbën një akt të shkëputur që varet vetëm nga zhvillimet e sistemit bankar apo dëshira e

mirë e institucionit për të realizuar detyrat në afatin e mesëm. Ajo do të kryhet në sfondin e domosdoshëm të reformës së transformimeve të gjithanshme ekonomike, institucionale e politike të vendit. Për pasojë, realizimi i këtij synimi do të interferojë reciprokisht segmente të ndryshme të këtij procesi tranzicioni, duke lënë edhe gjurmët e veta në të.

Me qëllim që të ndiqet ecuria e realizimit është ndërtuar edhe programi i punës i cili, kryen fazimin kohor dhe konkretizimin e parimeve të dokumentit të strategjisë. Ai do të ndiqet në vazhdimësi nga të gjitha strukturat e Bankës duke bërë edhe përshtatjet e nevojshme apo ato që dikton koha. Vendosja e afateve plotësisht të përcaktuara dhe njësive organizative përgjegjëse e bën akoma më të përgjegjshëm dhe bindës angazhimin e realizimit të këtij dokumenti.

Gjatë realizimit do të mbahet parasysh, gjithashtu, pasqyrimi i detyrave të kryera në zbatim të porosive edhe udhëzimeve të lëna nga misionet e FMN që diskutojnë programin monetar me Bankën e Shqipërisë; pasqyrimi i njohurive të reja në fushat e politikës dhe operacioneve monetare, në fushën e mbikëqyrjes, të kontabilitetit e pagesave si dhe të kërkimeve e statistikave të realizuara me ndihmën e misioneve të asistencës nga FMN, BB, USAID, etj; pasqyrimi i problemeve aktuale që mund të ndodhin gjatë zbatimit, si dhe zhvillimet pozitive institucionale.

Banka e Shqipërisë ka besim të plotë dhe ka angazhimin e duhur për vënien në jetë të këtij dokumenti.

**Prof. Dr. Marta Muço**

**Shefe e Kabinetit të Guvernatorit**